



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** dhe nenit 14, paragrafi **1** i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 21, të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), nenit 24, dhe nenit 25, paragrafi 3, nënparagrafi 3.3, të Rregullores QRK, nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 33.2, shkronja **a**, nenit 34.1 shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010 dhe kërkesës nr. 13-016/01-138373/22, dt. 16.06.2022, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.06.2022, mori këtë

V E N D I M
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS
OPERATORIT SISTEMIT, TRANSMISIONIT DHE TREGU “KOSTT” SH.A.

- I.** **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër Operatorit Sistemit, Transmisionit dhe Tregu “KOSTT” Sh.a.
- II.** Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim, e cekur në pikën I të këtij vendimi, është:
 1. Parcela kadastrale me nr. 7797-2, me sipërfaqe prej 144m², dhe parcela kadastrale me nr. 1498-103, me sipërfaqe prej 144m², Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna e Prishtinës.
- III.** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, të cekura në pikën II të këtij vendimi, është zhvendosja e Linjës 110kV me nr.1114 më saktësisht dislokimin e shtyllës elektrike nr.19, si dhe vendosjen e shtyllave 19B dhe 19A, e cila gjendet në zonën industriale në Prishtinë.
- IV.** Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është në afat 15 vite.
- V.** Prona e paluajtshme e cekur në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI.** Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit.
- VII.** Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.

- VIII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.
- IX.** Pjesë përbërëse e këtij propozimvendimi janë:
- kërkesa,
 - kopja e planit dhe certifikata e pronës.
- X.** Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-151658/22, më 30.06.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Arsyetim

Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu KOSTT sh.a., me shkresën nr.13-016/01-138373/22, dt. 16.06.2022, ka kërkuar nga Drejtoria e Pronës, shfrytëzimin e pronës komunale, për parcelat kadastrale: nr.7797-2, sipërfaqe prej 144m² dhe nr.1498-103, sipërfaqe prej 144m², Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna e Prishtinës.

Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është në afat 15 vite, mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës, do të caktohen me kontratë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit.

Andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore si në pjesën hyrëse të këtij Propozimi, dhe në shkresat e lëndës u vendos si në dispozitiv të këtij propozimi.